

VENDIM
Nr.363, datë 1.4.2009

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE,
SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI NË PËRDORIM TË KOMUNËS TOPOJË
TË QARKUT FIERIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Topojë të qarkut të Fierit, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 48 (dyzet e tetë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 253 (dyqind e pesëdhjetë e tre).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Topojë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

NUMRAT RENDORË TË PRONAVE NË LISTËN E INVENTARIT	FUSHA E PËRDORIMIT TË PRONËS	LLOJI I TRANSFERIMIT
1-12	PRONA QË PËRDOREN PËR REALIZIMIN E PROGRAMEVE ARSIMORE.	NË PRONËSI
13-19	PRONA QË PËRDOREN PËR REALIZIMIN E FUNKSIONEVE NË SHËNDETIN PUBLIK.	NË PRONËSI
20-35	PRONA QË PËRDOREN PËR REALIZIMIN E PROGRAMEVE KULTURORE SPORTIVE.	NË PRONËSI
42,43	SHËRBIM FUNERAL.	NË PRONËSI
36-41, 144-163	PRONA QË PËRDOREN NË FUSHËN E INFRASTRUKTURËS (TROJE).	NË PRONËSI
173-175	FURNIZIM ME UJË TË PIJSHËM	NË PRONËSI
44-79	PRONA QË PËRDOREN NË FUSHËN E MBROJTJES CIVILE.	NË PRONËSI
80,83,86,90	PRONA QË PËRDOREN NË FUSHËN E BUJQËSISË DHE TË USHQIMIT (TOKA PRODUKTIVE).	NË PËRDORIM
253 (PRONË SHITESË)	PRONA QË PËRDOREN NË FUSHËN ADMINISTRATIVE.	NË PRONËSI
81,82,84,85,87,88,89,91,134-136 (VETËM KANALE TË TRETA)	PRONA QË PËRDOREN NË FUSHËN E BUJQËSISË DHE TË USHQIMIT (TOKA JOPRODUKTIVE, KANALE TË TRETA).	NË PRONËSI